

Dhuratë e Kryqit të Kuq Shqiptar

Ne ndihmë të komunitetit për
përballimin e përmbytjeve



NJË RRUGËTIM I RRRITJES SË AFTËSIVE RIPËRTËRITËSE PËR PËRMBYTJET NË SHQIPËRI

RAPORT MBI PROGRAMIN E AFTËSIVE RIPËRTERITËSE PËR PËRMBYTJET

2018 - 2024

Kryqi i Kuq Shqiptar është organizata më e vjetër dhe më e madhe humanitare në Shqipëri. Me synimin për të forcuar qëndrueshmërinë e komunitetit dhe për të reduktuar ndikimin e përmbytjeve, Kryqi i Kuq Shqiptar, së bashku me Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (IFRC), u bënë pjesë e Aleancës së Zyrihut për Aftësitë Ripërtëritëse për Përmbytjet (Aleanca).

Përmbytjet janë rreziku më i zakonshëm dhe më i dëmshëm klimatik në Shqipëri. Përmbytjet pluviale, të shkaktuara nga reshjet e mëdha, dikojnë në jetët dhe burimet e jetesës së komuniteteve.

Duke përdorur kuadrin e Matjes së Aftësive Ripërtëritëse ndaj Përmbytjeve për Komunitetet (FRMC), programi u angazhua thellësisht me komunitetet lokale për të ndërtuar aftësitë tyre ripërtëritëse dhe integroi njohuritë dhe përvojat e tyre si në veprimet lokale ashtu edhe në strategjitë kombëtare. Zërat lokalë dhe mësimet e nxjerra u dokumentuan dhe u ndanë për të mbështetur ndikimin e politikave dhe zgjerimin e tyre përmes rrjetit të Kryqit të Kuq.

Gjithashtu programi synoi gjashtë komunitete rurale dhe periurbane në qarqet me rrezikun më të madh nga përmbytjet në Shqipëri: Shkodër, Fier dhe Vlorë duke marrë veprime me ndikim në nivel rajonal dhe kombëtar.

Ndërsa Aleanca feston mbi dhjetë vjet të funksionimit, ndikimi kolektiv i rritjes së aftësive ripërtëritëse ndaj përmbytjeve përmes veprimeve të komunitetit, është rritur dhe ka ndikuar punën e 10 partnerëve në shumë se 25 vende ku ka arritur mbi 3 Milionë njerëz.



Komunitetet janë më të ndërgjegjësuar për rrezikun, kanë më shumë njohuri, janë më të fuqizuar për të ndërmarrë veprime, dhe janë më të organizuar për të mbështetur popullsinë lokale përballë përmbytjeve.

- Ndhimja e parë, DRR dhe trajnime rreth shëndetit.
- Fushata lokale dhe kombëtare të ndërgjegjësimit për rrezikun.
- Rritja e ndërgjegjësimit në aktivitetet e zhvilluara në shkolla.
- Ekipet e reagimit të komunitetit.

Komunitetet ndihen shumë më të sigurt në veprimet e tyre ... ne mund të shohim se popullata lokale, nga brezi i ri e deri tek të moshuarit, është informuar dhe fuqizuar për të ndërmarrë veprime ripërtëritëse për përmbytjet.

Saidi Bushaj, Drejtues i Projektit, Kryqi i Kuq Shqiptar

+150,000

jetë të përmirësuar

Mendësi dhe sjellje të reja, infrastrukturë dhe politika që kanë një ndikim të qëndrueshëm pozitiv në jetën e njerëzve.

300,000

arritje indirekte

Popullsia që përfiton nga ndërhyrjet në komunitetet tona, duke u rritur dhe duke ndikuar në nisma të reja.



Aktivitetet e kryera në komunitetet rurale dhe peri-urbane dhe me aktorë lokalë dhe kombëtarë.



Infrastruktura lokale e mbrojtjes nga përmbytjet rrit qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj përmbytjeve.

- Muri mbrojtës nga përmbytjet.
- Ura e evakuimit.



Ne pamë se nevoja dominuese ishte evakuimi i njerëzve, bagëti dhe pajisjeve bujqësore nga zona bujqësore në zonën e banimit. Jemi të lumtur që përmes këtij projekti, ne arritëm ta bëjmë këtë realitet.

Sokol, vullnetar i Kryqit të Kuq Shqiptar



Zërat e komuniteti, nevojat dhe prioritetet lokale janë integruar në politikën kombëtare në lidhje me rritjen e aftësive ripërtëritëse ndaj përmbytjeve duke rezultuar në një sistem më koheziv, të organizuar dhe efektiv të mbrojtjes civile.

- Avokim lokal për investime në aftësitë ripërtëritëse për përmbytjet
- Ndikimi i politikave rajonale dhe kombëtare.
- Sjellja e aktorëve të ndryshëm drejt zhvillimit të një Sistemi të Paralajmërimit të Hershëm.

Ne zhvilluam një kanal të ri për zërin e komunitetit, që ai të mund të dëgjohet dhe të ndikojë në diskutimet e politikbërjen në nivel kombëtar dhe rajonal

Fatos Xhengo, Koordinator i Programit të Përgatitjes dhe Reagimit ndaj Fatkeqësive, Kryqi i Kuq Shqiptar

MËSIMI INSTITUCIONAL

Si pjesë e Aleancës së Zyrihut për Aftësitë Ripërtëritëse ndaj Përmytjeve, Kryqi i Kuq Shqiptar ka ndërmarrë një proces të të mësuarit institucional dhe pesë vitet e fundit ka pasur një ndikim të rëndësishëm në marrëdhëniet institucionale dhe mënyrat e punës.

- Qasje më e strukturuar dhe e qëllimshme ndaj aktiviteteve të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë.
- Forcimi i degëve të Kryqit të Kuq që mund të vazhdojnë të ndërtojnë qëndrueshmëri në nivel lokal.

- Prezantimi i konceptit të aftësive ripërtëritëse brenda Shoqatës Kombëtare dhe sistemit më të gjerë të Mbrojtjes Civile në Shqipëri
- Metodologjitë dhe mënyrat e reja të punës ofrojnë modele të suksesshme të ndërtimit të aftësive ripërtëritëse
- Rritja e angazhimit me komunitetet si bashkëpunëtorë afatgjatë dhe jo si përfitues.
- Transparencë dhe llogaridhënie më e madhe ndaj nevojave dhe prioriteteve të komunitetit.

Historia e Nekiut

Nekiu ka qenë drejtues lokal i komunitetit të Darëzezës për më shumë se një dekadë. Ai është entusiast dhe i vendosur për të kërkuar mundësi që komuniteti i tij të rritet dhe të zhvillohet. Në vitin 2017, reshjet e dendura të pandërprera çuan në rritjen e nivelit të lumenjve që shkaktuan përmytje në komunitetet e qarqeve të Vlorës dhe Fierit, duke përfshirë komunitetin e Darëzezës, ku anëtarët e komunitetit kërkuan të evakuonin pajisjet bujqësore, produktet dhe bagëtinë nga zonat më të ulëta të komunitetit në ato më të larta përtej lumit . Megjithatë, rritja e nivelit të lumit dëmtoi si urat e automjeteve ashtu edhe urat e këmbësorëve në dispozicion të popullatës lokale. Siç Nekiu shprehet: *„nëse do të kishim mundësinë të evakuonim produktet tona, më shumë se gjysma e komunitetit do ta kishte pasur më të lehtë të rikuperohej, por humbjet e mëdha e vonuan shumë kohën e rikuperimit“.*

Forcimi i infrastrukturës lokale për të lehtësuar evakuimin, veçanërisht në lidhje me mjetet e jetesës, u identifikua si një prioritet kyç nga popullata lokale përmes procesit të matjes së aftësive ripërtëritëse.

Në bashkëpunim me Bashkinë e Fierit dhe Ministrinë e Mbrojtjes, Kryqi i Kuq Shqiptar mbështeti ndërtimin e një ure më të gjerë, më të lartë dhe më të fortë për të rritur mundësinë e evakuimit në rast përmytjesh. Neki përsëriti suksesin e këtij projekti, *“në kohë normale, pothuajse të gjitha komunitetet përreth që punojnë në bujqësi e përdorin këtë urë për përdorim të përditshëm. Në kohë të rrezikuara nga përmytjet, kjo urë me siguri do të ndihmojë të gjithë fermerët të evakujnë veten, bagëtinë dhe të gjitha produktet e tjera që kultivohen në atë zonë.“*



REKOMANDIMET

Zhvillimi i suksesshëm i Programit të Aftësive Ripërtëritëse për Përmbytjet në Shqipëri ka shënuar një përmirësim thelbësor në aftësitë ripërtëritëse të komunitetit. Megjithatë, ndërsa rreziqet klimatike vazhdojnë të rriten, është e rëndësishme që qasjet tona të mbeten dinamike dhe inovatore; duke shfrytëzuar mësimet e nxjerra nga përvojat e mëparshme.



Kuptoni dhe komunikoni se si puna e programit kontribuon në kuadër më të gjerë.

- Ndërtoni këto aftësi në nivele të ndryshme me individët, familjet, autoritetet lokale dhe palët e interesuara në nivel kombëtar.
- Përdorni fushata në shkallë të gjerë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbulimin mediatic për të ndarë mesazhet kryesore.



Jepni përparësi ndërhyrjeve që janë të udhëhequra nga komuniteti, të prekshme dhe të qëndrueshme.

- Aplikoni matjen e aftësive dhe vlerësoni cenueshmërinë për të mbështetur hartimin e ndërhyrjeve të bazuara në prova.
- Jepini përparësi zgjidhjeve të preferuara të komuniteteve për angazhim dhe pranim më të gjerë.
- Bashkëpunoni me komunitetet si partnerë.
- Balanconi ndërgjegjësimin dhe ndërhyrjet për ngritjen e kapaciteteve me masa të prekshme për aftësitë ripërtëritëse ndaj përmbytjeve.



Angazhohuni me autoritetet lokale për të rritur shkallën, zbatimin dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve.

- Ndërtoni dhe ushqeni marrëdhënie me palët e interesuara me komunikim proaktiv dhe të qëndrueshëm.
- Eksploroni mundësitë për bashkëfinansim me autoritetet lokale për të siguruar qëndrueshmërinë e projektit.



Përdorni fuqitë organizative për rritjen dhe qëndrueshmërinë.

- Shfrytëzojeni pozicionin e Kryqit të Kuq në dialogun kombëtar dhe në politikëbërjen për të siguruar që zërat vendorë të dëgohen.
- Forcimi i degëve lokale të Kryqit të Kuq dhe shkëmbimi i gjerë i praktikave më të mira.



Aleanca e Rritjes së Aftësive Ripërtëritëse për Përmbytjet e Zyrihut është një partneritet shumë-sektorial i fokusuar në gjetjen e zgjidhjeve praktikive për të ndihmuar komunitetet në rritjen e aftësive ripërtëritëse të komuniteteve ndaj përmbytjeve në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim

Zbuloni më shumë: www.floodresilience.net



LE XO
RAPORTIN
E PLOTË
KËTU